



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 68, datë 28.04.2021

MBI
PEZULLIMIN E SHPËRNDARJES SË FITIMIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT PËR
VITIN 2020

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 149 e vijues të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Në kuadër të masave të ndërmarra për përballimin e pasojave të pandemisë Covid-19, Bordi i Autoritetit mori vendimin nr. 56, datë 10.04.2020 “*Për marrjen e masave nga shoqëritë e sigurimeve për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19*”.

Referuar raportit të stabilitetit financiar të dhjetorit 2020, të Autoritetit Evropian Rregullator të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), pas një analize lidhur me efektet e pandemisë Covid-19 në tregun evropian të sigurimeve, rekomandohet që tregu i sigurimeve duhet të marrë në konsideratë që çdo shpërndarje e dividendëve dhe shpërblimeve variabël të mos çënojë treguesit e shëndetit financiar, me qëllim mbajtjen e tyre brenda kërkesave ligjore duke garantuar mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Autoriteti, gjatë monitorimit të zhvillimeve në tregun e sigurimeve, për vitin 2020, konstaton se tregu i sigurimeve ka arritur të përballojë situatën e vështirë të krijuar nga pandemia Covid-19 dhe paraqitet i qëndrueshëm në terma të treguesve kryesorë të shëndetit financiar.

Gjithsesi, me qëllim ruajtjen e nivelit të likuiditetit dhe treguesve financiarë të shoqërive të sigurimit, për shkak se nuk parashikohet kohëzgjatja e pandemisë Covid-19, konsiderohet e

nevojshme pezullimi i shpërndarjes së fitimit të vitit 2020, duke lejuar shpërndarjen e fitimit të vitit 2019.

Në këto kushte, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Shoqëritë e sigurimit të pezullojnë shpërndarjen e fitimit të vitit 2020, në formën e dividendëve ose të dividendëve të ndërmjetëm ose në formën e pagesave të bazuara në pjesëmarrjen në fitim të anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë apo punonjësve të tjerë.**
- 2. Shoqëritë e sigurimit duhet të marrin masa dhe të zbatojnë një qasje konservative në lidhje me shpërblimet variabël, bazuar në politikat e tyre dhe në çdo rast shtyrjen e tyre në kohë.**
- 3. Vendimi i Bordit të Autoritetit nr. 56, datë 10.04.2020, shfuqizohet.**
- 4. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE